

“PROMOVIMI I VLERAVE SOCIALE NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË”

TEMA PËR TITULLIN
DOKTOR I SOCIOLOGJISË
NGA

MUHABERE MALIQI



PUNIMI I DOKTORATËS

Prishtinë, 2022

REZYME E PUNIMIT TË DOKTORATËS

“PROMOVIMI I VLERAVE SOCIALE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË”

Mentor: Prof. Dr. Agim Hyseni

Studimi për promovimin e vlerave sociale në sistemin arsimor parauniversitar është me rëndësi të veçantë duke marrë parasysh faktin se ka pak studime nga kjo fushë në Kosovë. Rëndësia në trajtimin e kësaj teme është e madhe duke marrë parasysh faktin se shoqëria kosovare ka kaluar një fazë të tranzicionit të thellë në të gjitha aspektet si politike, ekonomike e shoqërore. Ky studim në fokus ka hulumtimin e ndikimit që kanë pasur reformat në arsimin parauniversitar, duke filluar me implementimin e kurrikulës të bazuar në kompetenca, në promovimin e vlerave sociale. Përveç trajtimit të dokumentacionit relevantë, hulumtohen opinionet dhe vlerësimet e mësimdhënësve për promovimin e vlerave sociale si dhe faktorët që ndikojnë në zbatimin e kurrikulës për lëndën e edukimit qytetar. Ky studim është realizuar duke përdorur metoda kualitative dhe kuantitative për arritjen e rezultateve, duke përfshirë analizën e përmbajtjes dhe anketimin e mësimdhënësve të lëndës së edukatës qytetare. Popullata e synuar për këtë studim janë mësimdhënësit e lëndës së edukatës qytetare në arsimin parauniversitar në Kosovë. Studimi është bërë në gjithë vendin duke anketuar përmes pyetësorit 349 mësimdhënës. Për analizën e të dhënave u përdor paketa statistikore e shkencave sociale (SPSS, 25) e poashtu edhe paketa statistikore (STATA, 13).

Rezultatet e studimit treguan se shumica e mësimdhënësve e kuptojnë kornizën kurrikulare duke përfshirë kurrikulën bërthamë dhe lëndore, dhe vlerësojnë se promovohen vlerat sociale përmes kompetencës së qytetarisë.

Gjithashtu, rezulton se tekstet shkollore për lëndën e edukatës qytetare, përkundër se nuk janë të hartuara sipas kurrikulës së paraparë, ato promovojnë në nivel të mjaftueshëm vlerat sociale. Ndërsa gjetjet e studimit tregojnë se kushtet e papërshtatshme të punës, mungesa e pajisjeve dhe trajnimeve adekuate kanë një efekt negativ në zbatimin e kurrikulës të bazuar në kompetenca. Rekomandimet theksojnë nevojën për një rishikim të teksteve shkollore bazuar në kërkesat e kornizës kurrikulare, trajnime shtesë të mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca dhe domosdoshmërinë për sigurimin e kushteve adekuate të punës për mësimdhënësit.

Fjalë kyçe: vlera sociale, kompetenca qytetare, tekste shkollore, kurrikula.

STRUKTURA E DISERTACIONIT

Struktura e disertacionit të doktoratës me titull “Promovimi i vlerave sociale në arsimin parauniversitar në Kosovë” përveç pjesës hyrëse, përmban tetë kapituj, ka përfundimet, rekomandimet, literaturën e shfrytëzuar, si dhe anekset e veçanta, në të cilat janë paraqitur pyetësi dhe anketat e realizuara me mësimdhënës.

Hyrja e studimit- Duke filluar me pjesën e parë që trajton problematikën dhe rëndësinë e vlerave sociale në arsim, Hyrja ka përfshirë qëllimin e studimit, objektivat e studimit, pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë, rolin dhe rëndësinë e studimit, limitimet apo kufizimet kryesore, materialet e përdorura, metodologjinë e studimit, parashtrimin e problemit dhe strukturën e punimit.

Pjesa e dytë, korniza teorike dhe rishikimi i literaturës, përfshinë aspektin teorik të arsimit dhe të sociologjisë së edukimit, duke trajtuar edhe teoritë e sociologjisë së edukimit.

Ne vazhdim trajton vlerat sociale si dhe edukimin për vlerat. Gjithashtu shtjellohet edhe edukimi i bazuar në kompetenca, ku bazohet edhe kurrikula e arsimit parauniversitar në Kosovë. Pastaj është bërë edhe një rishikim i literaturës empirike nga autorë të ndryshëm për temën në fjalë.

Pjesa e tretë, trajton sistemin arsimor në Republikën e Kosovës duke përfshirë aspektin ligjor mbi bazën e së cilës realizohet arsimi parauniversitar në Kosovë, duke vazhduar me shqyrtimin e kornizës së kurrikulës së arsimit parauniversitar dhe kurrikulat bërthamë dhe ato lëndore në Republikën e Kosovës. Më tej trajtohet në mënyrë specifike kompetenca e qytetarisë, si pjesë qëndrore e këtij studimi, duke ofruar objektivat dhe qëllimet për kompetencën e qytetarisë. Në fund të kapitullit ofrohet një analizë e strukturës së sistemit arsimor parauniversitar në Kosovë, e cila ka shërbyer edhe për analizën e gjendjes dhe popullatës së synuar dhe njëherit si baza mbi të cilën janë pëcaktuar mostra për hulumtim të metejmë bazuar në objektivat dhe pyetjet kërkimore të këtij studimi.

Pjesa e katërt përshinë metodologjinë hulumtuese si dhe metodat e instrumentet e përdorura për këtë studim. Paraqiten hipotezat dhe operacionalizimi i tyre, dizajni i studimit, popullata e synuar dhe pjesëmarrësit në studim, instrumentet me të cilat është kryer hulumtimi, pilotimi i instrumentit dhe procedura e mbledhjes së të dhënave.

Pjesa e pestë përfshinë rezultatet e studimit ku janë ofruar përfundimet që janë nxjerrë nga analizat statistikore të të dhënave. Në këtë kapitull pasqyrohen analizat deskriptive të të dhënave, si dhe prezantohet testimi i hipotezave.

Gjithashtu është ofruar analiza e pyetjeve të hapura që kanë të bëjnë me opinionet e mësimeve lidhur me vlerat sociale të promovuara përmes kurrikulës, vërejtjet e tyre shtesë për këtë çështje si dhe pengesat e identifikuar nga ana e tyre për realizmin me sukses të kurrikulës së re në veçanti për kompetencën e qytetarisë.

Pjesa e gjashtë – përfshinë shyrtrimin dhe diskutimin e rezultateve ku janë përmbledhur gjetjet e hulumtimit dhe janë ofruar analizat për rezultatet e hulumtimit. Gjithashtu janë ofruar disa krahasime me hulumtime e studime nga kjo fushë.

Pjesa e shtatë - përfshinë pjesën e përfundimeve të cilat bazohen në gjetjet e këtij hulumtimi nga analiza e të dhënave dhe rezultateve. Janë ofruar konkluzionet lidhur me objektivat dhe pyetjet kërkimore të studimit bazuar në rezultatet e studimit. Gjithashtu janë dhënë disa rekomandime lidhur me promovimin e vlerave sociale dhe zbatimit të kurrikulës së re në veçanti për kompetencën e qytetarisë.

Pjesa e tetë – përmban literaturën dhe burimet e shfrytëzuara për këtë studim.

DOCTORAL DISSERTATION SUMMARY

“PROMOTION OF SOCIAL VALUES IN PRE-UNIVERSITY EDUCATION IN KOSOVO”

Mentor: Prof. Dr. Agim Hyseni

The study on the promotion of social values in the pre-university education system is of particular importance given the fact that there are few studies in this field in Kosovo. There is a huge importance in addressing this topic given the fact that Kosovar society has gone through a phase of deep transition in all aspects such as political, economic and social. This study focuses on researching the impact of the reforms in pre-university education, starting with the implementation of a competency-based curriculum in the promotion of social values. In addition to the analyzing of relevant documentation, the opinions and evaluations from teachers are investigated for the promotion of social values, as well as for other factors that influence the implementation of the curriculum for the subject of civic education.

This study was conducted using qualitative and quantitative methods to achieve the results, including content analysis and survey of teachers of civic education. The target population for this study are teachers of civic education in pre-university education in Kosovo. The study was conducted nationwide by surveying 349 teachers through a questionnaire. The statistical package of social sciences (SPSS, 25) as well as the statistical package (STATA, 13) were used for data analysis.

The results of the study showed that most teachers understand the curricular framework including the core and subject curriculum, and as per their opinions the social values are promoted through civic competence. Also, it turns out that textbooks for the subject of civic education, despite not being designed according to the prescribed curriculum, they sufficiently promote social values. While the study findings show that inadequate working conditions, lack of adequate equipment and training have a negative effect on the implementation of competency-based curriculum.

The recommendations emphasize the need for a revision of textbooks based on the requirements of the curriculum framework, additional training of teachers for the implementation of the competency-based curriculum and the need to ensure adequate working conditions for teachers.

Keywords: social values, civic competences, textbooks, curricula.

DISSERTATION STRUCTURE

The structure of the doctoral dissertation entitled "Promotion of social values in pre-university education in Kosovo" in addition to the introductory part, contains eight chapters, including conclusions, recommendations, literature used, and annexes, where are presented questionnaires and surveys conducted with teachers.

Introduction to the study- Starting with the first part that deals with the problems and importance of social values in education, the Introduction includes the purpose of the study, study objectives, research questions and basic hypotheses, the role and importance of the study, main limitations or limitations, materials used, study methodology, problem presentation and paper structure.

The second part, the theoretical framework and review of the literature, includes the theoretical aspect of education and sociology of education, addressing the theories of sociology of education.

In addition, the study addresses the social values as well as values education. Competence-based education is elaborated, based on the pre-university education curriculum in Kosovo. Furthermore, a review of the empirical literature by various authors on the topic was conducted.

The third part deals with the education system in the Republic of Kosovo, including the legal aspect on the basis of which pre-university education is realized in Kosovo, continuing with the review of the pre-university education curriculum framework including core and subject curricula in the Republic of Kosovo. Civic competence is further addressed specifically, as a central part of this study, providing objectives and goals for citizenship competence. At the end of the chapter is provided an analysis of the structure of the pre-university education system in Kosovo, which has served for the analysis of the situation and the target population and also as a basis on which samples are determined for further research based on objectives and research questions. of this study.

The fourth part includes the research methodology as well as the methods and instruments used for this study. The hypotheses and their operationalization, the design of the study, the target population and the participants in the study, the instruments with which the research was conducted, the piloting of the instrument and the data collection procedure are presented.

The fifth part includes the results of the study where the conclusions drawn from the statistical analysis of the data are presented. This chapter reflects the descriptive analysis of the data, as well as introduces hypothesis testing.

Furthermore, an analysis is done related to open-ended questions related to teachers' opinions regarding the social values promoted through the curriculum, their additional remarks on this issue as well as the obstacles identified by them for the successful implementation of the new curriculum in especially for the competence of citizenship.

Part six - includes reviewing and discussing the results where the research findings are summarized and analyzes of the research results are provided. Some comparisons with other research and studies in this field are also provided.

Part seven - includes the part of the conclusions, which are based on the findings of this research from the analysis of data and results. Conclusions regarding the objectives and research questions of the study based on the results of the study are provided. There are also some recommendations regarding the promotion of social values and the implementation of the new curriculum in particular for civic competence.

Part eight – contains the literature and resources used for this study.